



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**SHOQERIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIMË GJIROKASTER SH.A**  
**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

Nr                      Prot.    Gjirokastër, më ...../...../2024

**Shtojca 10**

*Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]*

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT 1**

*( NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT*

Drejtuar:                      Kreatx”                      me                      adrese                      Seli/Zyra                      Qendrore:  
Tiranë, Njësia Bashkiake nr. 5, Rruga Tish Daija, Kompleksi Kika 2, Godina 1, Shkalla 1, Zyra nr.2

Procedura e prokurimit/lotit: ***Procedure e hapur e thjeshtuar***

**Numri i referencës së procedurës /Lotit:**                      REF-08392-06-06-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *“Mirembajtje programit te faturimit dhe fiskalizim i faturave”*

**Fondi limit: 6,933,333** (gjashtemilion e nenteqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë)  
*Lekë pa Tvsh,*

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike NR.30 Data 10  
*Qershor 2024*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

<sup>1</sup> Ky Formular është i aplikueshëm nëse ka Ankime

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. "Ilirjana Qoku" NUIS: M21403009A me oferte ekonomike 0 leke pa tvsh
2. "Infosoft systems" NUIS:J61820021C me oferte ekonomike 0 leke pa tvsh
3. "Kreatx" NUIS: L12121023B me oferte ekonomike 5 950 000 leke pa tvsh
4. "Primus Albania" NUIS:L42202028V me oferte ekonomike 5 199 999,75 leke pa tvsh

**Shenim: OE "Primus Albania" me NUIS:L42202028V ka marrë pjesë si bashkim operatorësh me OE Nexia AI Consulting NUIS L82210031Q në këtë procedurë ku OE Primus Albania NUIS:L42202028V ka 60 % dhe OE Nexia AI Consulting me NUIS L82210031Q ka 40 %**

Primus Albania NUIS:L42202028V  
Nexia AI Consulting NUIS L82210031Q

#### **U kualifikuan operatorët si me poshte:**

1. "Kreatx" NUIS: L12121023B me oferte ekonomike 5 950 000 leke pa tvsh

#### **U skualifikuan operatorët si me poshte:**

1. "Ilirjana Qoku" NUIS: M21403009A me oferte ekonomike 0 leke pa tvsh
2. "Infosoft systems" NUIS:J61820021C me oferte ekonomike 0 leke pa tvsh
3. "Primus Albania" NUIS:L42202028V me oferte ekonomike 5 199 999,75 leke pa tvsh

#### **Arsyet e skualifikimit :**

- Operatori ekonomik **Ilirjana Qoku** nuk ka paraqitur në SPE asnjë dokument që të vertetojë përmbushjen e kriterëve të kërkuara nga AK në dokumentat standarte të tenderit.
- Operatori ekonomik **Infosoft Systems** nuk ka paraqitur në SPE asnjë dokument që të vertetojë përmbushjen e kriterëve të kërkuara nga AK në dokumentat standarte të tenderit.
- Operatori ekonomik **Primus Albania** L42202028V **bashkim operatorësh me Nexia AI Consulting** K91721010Q. Autoriteti kontraktor në kuadër të zbatimit të hapave ligjore të percaktuara në LPP dhe Rregullat e Prokurimit publik si dhe në zbatim të plotë të vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.1459/20224 Prot. datë 17.10.2024: III.5.8 Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe

personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.6.7 Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, referur shtojcës 1 të DST çmimi total i ofertës së dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë është 5,199,999.75 lekë pa tvsh, ndërkohë referuar shojcës 2 të DST “Lista e çmimeve të shërbimeve” të DST, BOE “Primus Albani” SHPK dhe “Nexia Al Consulting” SHPK kanë përcaktuar çmimin për secilën njësi sipas të cilës rezulton se: për zërin dorëzimi i pajisjeve mobile PDA dhe vënia në punë e tyre çmimi total për shërbim 690,000 lekë pa TVSH, për zërin upgrade i sistemit ekzistues flare billing 117,999.75 lekë pa TVSH, për zërin vendosja e modulit të leximit 120,000 lekë pa tvsh, për zërin vendosja e modulit të fiskalizimit 1,920,000 lekë pa tvsh, për zërin licensa përdorimi, mirëmbajtje në cloud e sistemit të upgraduar me të gjithë funksionalitetet, integrimet, me modulet e reja, pajisjet PDA 2,352,000 lekë pa tvsh. Referuar marrëveshjes së bashkëpunimit datë 31.07.2024 të lidhur ndërmjet operatorëve ekonomikë “Primus Albania” SHPK dhe “Nexia AL Consulting” SHPK në nenin 4 të kësaj marrëveshje përcaktohet se operatori ekonomik “Primus Albania” SHPK do të mbulojë 60 % të angazhimit të kontratës kryesore, ndërsa operatori ekonomik “Nexia Al Consulting” SHPK do të mbulojë 40 % të angazhimit të kontratës kryesore. Referuar ndarjes së shërbimeve rezulton se operatori ekonomik “Primus Albania” SHPK do të kryejë shërbimet si: zërin 1. dorëzimi i pajisjeve mobile PDA dhe vënia në punë e tyre, zëri 2. upgrade i sistemit ekzistues Flare Billing, zëri 3. vendosja e modulit të leximit, ndërsa operatori ekonomik “Nexia Al Consulting” SHPK do të realizojë zërin.4 vendosja e modulit të fiskalizimit, ndërsa zëri 5. Licensa përdorimi, mirëmbajtje në cloud e sistemit të upgraduar me të gjitha funksionalitetet, integrimet, me modulet e reja, pajisjet PDA do realizohen nga operatori ekonomik “primus Albania” SHPK dhe “nexia Al Consulting” SHPK. Referuar zërave që do të realizojë secili prej operatorëve

ekonomikë sipas marrëveshjes së bashkëpunimit, si dhe bazuar në ofertën ekonomike Komisioni konstaton se operatori ekonomik “Primus Albania” SHPK do të mbulojë 44.98 % të kontratës, ndërsa operatori ekonomik “Nexia AI Consulting” SHPK do të mbulojë 55.02 % të kontratës. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe legjislacionin në fuqi. Është barrë e operatorit ekonomik ankimues pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekti-shqyrtimi, të paraqesë informacion dhe dokumentacion të saktë dhe të vërtetë se i plotëson të gjitha kërkesat dhe kushtet e parashikuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Autoriteti kontraktor, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e lex specialis për prokurimin publik. Sa më sipër pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomik ankimues nuk qëndron.

***Ne zbatim të Vendimit nr.1638/2024 me numer 2577/18 prot date 19.11.2024 pika i per vijimin e hapave te metejshme te procedures se prokurimit***

1. Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë ” Kreatx” me adrese **Seli/Zyra Qendrore: Tiranë, Njësia Bashkiake nr. 5, Rruga Tish Daija, Kompleksi Kika 2, Godina 1, Shkalla 1, Zyra nr.2** se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 5 950 000 (pese milion e nentqind e pesedhete mije) leke pa TVSH me NIPT : L12121023B / totali i pikëve të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Gjirokaster me adrese Rr Muahrrem Gega, Gjirokaster* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO  JO  X

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*) \_\_\_\_\_

**[TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR]**

**Gentian Llogo**

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Gentian LLOGO**